


Shtimi i funksionalitetit të Vulës Digjitalë në Gjeoportalin Kombëtar



Në kuadër të digjitalizimit të shërbimeve dhe sipas procedurave të parashikuara në VKM-në nr. 399, datë 19.06.2019, "Rregullat për Shkëmbimin e Grupeve dhe të Shërbimeve të të Dhënave Gjeohapësinore mes Autoriteteve Publike", ASIG vë në dispozicion të autoriteteve publike, pa pagesë, informacionin gjeohapësinor duke përdorur shërbimet e Gjeoportalit Kombëtar. Së fundmi është shtuar funksionaliteti i printimit me vulë digjitalë nga faqja e Gjeoportalit Kombëtar, për përdoruesit e autoriteteve publike të regjistruar. Për më tepër informacion mbi përdorimin e këtij funksionaliteti [klikoni këtu](#).

Krijimi i Web App për QTTB në ArcGIS Online

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional me Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), ASIG ka ndërtuar një web app në platformën e ArcGIS Online, i cili shfaq informacione për zonat me interes të QTTB. Ky web app shërben për të aksesuar ortoimazherinë, serrat bujqësore, footprint-et e imazheve satelitore (të cilat japin informacion mbi datat e fotografimit të imazheve), CIR (Imazh InfraRed), NDWI (i cili shërben për identifikimin e trupave ujorë sipërfaqësorë dhe montorimin e tyre), si dhe NDVI (i cili shërben për monitorimin e shëndetit të bimësisë).





Publikime në Gjeoportalin Kombëtar

Harta Bazë


Në Gjeoportalin Kombëtar është publikuar shtresa e re "Harta Bazë". Kjo hartë iu shërben të gjithë përdoruesve për të aksesuar disa informacione në një shtresë të vetme dhe është realizuar duke përdorur të dhëna ekzistuese mbi infrastrukturën rrugore, emërtimet gjeografike, hidrografinë, ndërtesat dhe relievin, të cilat janë publikuar më herët në gjeoportalin.

"Harta bazë" ndërthuret edhe me produkte të tjera me saktësi të lartë si Harta Topografike 1:2000, për të cilën ASIG si Autoritet Publik Përgjegjës është angazhuar ta ndërtojë për zonat më të rëndësishme urbane.

Për mënyrën e aksesimit dhe të përdorimit të kësaj shtrese [klikoni këtu](#).



Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit



Në Gjeoportalin Kombëtar të ASIG është publikuar informacionin gjeohapësinor për temën "Infrastruktura për monitorimin e mjedisit".


Ky publikim u realizua në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), dhe përmban informacion në lidhje me monitorimin e lagunave, ujërave të liqeneve, ujërave të lumenjve për metalet e rënda, ujërave të lumenjve (tributarët), vetive fiziko-kimike të ujërave të lumenjve, ujërave të shkarkimeve, ujërave mikrobiologjik larës, vetive fiziko-kimike të ujërave bregdetare dhe ndotjes nga zhurmat urbane.

Ortoimazheria

ASIG ka prodhuar dhe publikuar në Gjeoportalin Kombëtar Ortofoton e Vitit 1957.

Falë bashkëpunimit të suksesshëm me Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU), u realizua skanimi i fotografive ajrore të nxjerra nga arkivat e tij, dhe realizimi i kësaj ortofotoje në formatin pankromatik (bardhë e zi), me një rezolucion 70 cm.

Kjo ortofoto mbulon rreth 5400 km² të Ultësirës Perëndimore, si dhe qytetin e Korçës.




PJESËMARRJE NË AKTIVITETE

Konferenca e 16-të Evropiane e Hapësirës

Përfaqësues të ASIG, Znj. Vilma Tomço, Drejtor i Përgjithshëm dhe Z. Dritan Prifti, Drejtor i Drejtorisë së Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing, nderuan me pjesëmarrjen e tyre në Konferencën e 16-të Evropiane të Hapësirës dhe në Asamblenë e Përgjithshme të Rrjeteve Hapësinore të BE-së, të cilat u zhvilluan në datat 23 - 24 janar 2024, në Bruksel, Belgjikë.

Këto forume të nivelit të lartë mbledhin së bashku palët kryesore të interesit nga institucionet e BE-së dhe shteteve anëtare, Agjencisë Evropiane të Hapësirës, industrisë hapësinore dhe akademisë për të diskutuar të ardhmen e hapësirës brenda kontekstit evropian.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Prezantimi i YellowScan Navigator, një sistem batimetrik novator LiDAR i dedikuar për hartat e bregdetit dhe lumenjve nëpërmjet dronëve

YellowScan Navigator është një zgjidhje novatore batimetrike LiDAR, i cili përmban një skaner lazer të zhvilluar posaçërisht gjatë pesë vjeçarit të fundit dhe është testuar mjaftueshëm për të arritur një performancë optimale. Ky sistem kompakt është përshtatur për të krijuar hartat e bregdetit dhe lumenjve në një diapazon thellësie nga 0 deri në 3 metra, duke arritur një thellësi prej 18 metrash në kushtet kur ujërat janë krejtësisht të pastra. Gjithashtu, sistemi ka një kamera të integruar për të mundësuar ngjyrosjen e të dhënave sipas ngjyrave reale të dedektuara.

Placer.ai dhe Esri krijojnë partneritet për të ofruar analizimin e të dhënave gjeohapësinore

Placer.ai, një kompani e fokusuar në analizimin e vendndodhjeve dhe Esri, një kompani teknologjike e sistemit të informacionit gjeografik (GIS), prezantuan një partneritet strategjik për të mundësuar analiza të avancuara, që iu mundësojnë përdoruesve të tyre integrimin e aftësive të analizës së sjelljes konsumatore sipas vendndodhjes specifike dhe inteligjencës së zonës tregtare.

Techtree prezanton platformën e hartave gjeohapësinore 3D

Kompania Techtree Innovation ka lançuar "AROUND", një platformë hartash gjeohapësinore 3D me precizion dhe rezolucion të lartë, e cila është krijuar për të përmirësuar cilësinë dhe saktësinë e hartave ekzistuese 3D. Platforma "AROUND" bazohet në teknologjinë ekzistuese të krijimit dhe paraqitjes së hartave 3D, duke ofruar zgjidhje për aplikime të ndryshme industriale, si planifikimi urban, menaxhimi i fatkeqësive, etj...

AKTIVITETE NË VIJIM

2024 EGU General Assembly

European Geosciences Union (EGU) organizon në Vjenë, Austri, Asamblenë e Përgjithshme Vjetore dedikuar gjeoshkencëtarëve në të gjitha disiplinat e shkencave të Tokës, planetare dhe hapësinore. Ky aktivitet synon të sigurojë një forum ku shkencëtarët dhe studiuesit e rinj të paraqesin punimet e tyre, si dhe të diskutojnë idetë e tyre me ekspertë të të gjitha fushave të gjeoshkencës.

14-19 Prill 2024

www.asig.gov.al

Geospatial World Forum (GWF)

Forumi Botëror Gjeohapësinor (GWF) organizon në Rotterdam, Mbretëria e Holandës, një konferencë katër ditore për profesionistë të angazhuar në përfaqësimin e gjithë ekosistemit të politikave publike, agjencive kombëtare të hartografisë, sektorit privat, organizatave, institucioneve shkencore dhe akademike.

13-16 Maj 2024

International Conference on Satellite Imagery and GIS Geography (ICSIGISG)

Instituti i Kërkimeve Teknike dhe Akademike (ITAR) organizon në Hamburg, Gjermani, Konferencën Ndërkombëtare të Imazheve Satelitore dhe Gjeografisë GIS dhe ka për qëllim të sjellë profesionistë të industrisë, ekspertë, akademikë dhe studiues për të diskutuar mbi ekspertizat dhe bashkëpunimet e tyre.

10 Qershor 2024

www.geoportal.asig.gov.al